

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ministrja që Rama po kërkon
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/ministrja-qe-rama-po-kerkon-i585355
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 10:08:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 10:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9bc03b46b79a320d2ddeae01be9b9b1ae3468b1a4d22e5aebb4af917f3372625
TEKSTI	ea4f67c467d627db5ad8c214209d764e635cf064bfc84feae80b7e82f248398e
PAMJA	be760c8a43f23f5973896daea16ee62de1c71f96054a208a8e217db56d3d59dc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	262ae81418cbb3d6b0375202a151692b72ce1da8bbdd205491b51c4378898530
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/262ae81418cbb3d6b0375202a151692b72ce1da8bbdd205491b51c4378898530>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e FOTO/ Bianca Censori habit me transformimin. Hoke bjonde dhe te brendshme te arta ne pozat e rejaPo trafikonte 11 klandestine nga Pakistani dhe Bangladeshi drejt vendeve te BE. arrestohet 2 fundit

Ministrja që Rama po kërkon

11 Shtator 2026, 12:40Blog Nga Albatros Rexhaj



Kur e pyeta Edi Ramën pse Klodiana Spahiu, përgjigjja erdhi në tre fjalë: e përlurur, profesioniste, besnike.

Sa më shumë e mendoj përgjigjen, aq më pak më duken tri cilësi të rastësishme. Më duken si përshkrimi i ministres që Rama po kërkon për këtë fazë të qeverisjes së tij. Dhe Shëndetësia është ndoshta vendi më i mirë për të parë nëse e ka gjetur.

Spahiu vjen me një avantazh që nuk blihet me seminar. E njeh spitalin nga brenda. Ka qenë mjeke në pavion, ka drejtuar për një periudhë spitalin e Durrësit dhe e di çfarë ndodh midis një vendimi të marrë në ministri dhe pacientit që pret në korridor.

Ajo distancë është një nga sëmundjet e vjetra të shëndetësisë sonë. Në letër ke mjek; në spital nuk e gjen. Në inventar ke aparaturën; kur të duhet, të thonë se është prishur dhe të dërgojnë matanë rrugës te privati. Buxheti e ka paguar ilaçin; pacienti del nga spitali me recetën në dorë për ta blerë jashtë. Investim, kontratë, reformë, statistikë, gjithçka ekziston, vetëm shërbimi mungon. Ministrja e Shëndetësisë nuk matet me atë që shteti thotë se ka ndërtuar. Matet me atë që qytetari gjen kur i dhemb diçka.

Prandaj fjala “e përlurur” këtu nuk është zbulurim karakteri. Për këtë fjalë nuk u mjaftova me vlerësimin e kryeministrit; pyeta poshtë e lart njerëz që e njohin nga spitali dhe nga Kuvendi, dhe përgjigjja ishte pothuajse kudo e njëjta: po, është grua me këmbë në tokë. Në shëndetësi ajo cilësi është mënyrë pune. Ministrja e përlurur nuk beson se sistemi funksionon sepse raporti që i ka ardhur në tavolinë thotë se funksionon. Shkon, ulet në spital, flet me mjekun, infermieren dhe pacientin, dhe pyet pse ka radhë, pse aparatura rri, pse ilaçi mungon, pse dikush nga Kukësi apo Gjirokastra duhet të vijë në Tiranë për diçka që duhet ta marrë afër shtëpisë. Jo për fotografi.

Profesionalizmi ka po aq kuptim praktik. Spahiu është mjeke. Nuk ka nevojë t’ia shpjegojë kush se çfarë do të thotë një ekzaminim i vonuar, një specialist që mungon apo një repart që funksionon vetëm në organikë. E ka parë anën tjetër të sportelit, dhe kjo e bën më të vështirë që sistemi ta mashtrojë.

Por fjala që më intereson më shumë është e treta.

Jo se dua të bëj filozofi me besnikërinë politike. Rama ka të drejtë të zgjedhë ministra të cilëve u beson; çdo kryeministër e bën. Pyetja është çfarë prodhon ai besim.

Rama po përpaket të fusë në qeverisje një ide që e ka quajtur BESA dhe një mënyrë pune që e ka quajtur Prania Besnike. Në thelb është e thjeshtë: qytetari nuk duhet të ketë përballë një shtet që flet me veten, por dikë që dëgjon, dikë që përgjigjet dhe dikë që nuk e lëshon problemin derisa të marrë zgjidhje.

Unë e besoj Ramën kur thotë se këtë herë e ka seriozisht. Jo nga ndonjë besim i veçantë te fjala e kryeministrave. Thjesht nuk i duhet kjo manovër. Pushtetin e ka. Opozitë që t’ia marrë nuk ka përpara. BESA nuk i duhet për të mbijetuar as edhe një muaj në zyrë. Kjo nuk e provon sinqeritetin e tij; një lider me pushtet të sigurt mund të bëjë edhe komunikim, edhe trashëgimi. Por është arsyeja kryesore pse jam i prirur ta besoj, dhe pse mendoj se nisma vjen nga një pyetje tjetër: tani që e ka përsëri pushtetin, çfarë do të bëjë me të? Jo si të fitojë zgjedhjet e radhës, por si ta bëjë administratën që drejton të sillet ndryshe me qytetarin.

Nëse është kështu, Klodiana Spahiu nuk është thjesht ministre e re e Shëndetësisë. Është një nga provat e para nëse ai reflektim mund të bëhet mënyrë qeverisjeje. Dhe në shëndetësi prova është brutalisht konkrete, sepse pacienti nuk kërkon leje ndërtimi apo përgjigje administrative. Ka frikë, ka dhimbje, ndoshta ka një fëmijë të sëmurë në krah, dhe organigrama nuk i hyn në punë.

Prania Besnike në Shëndetësi nuk është Spahiu që shfaqet çdo javë në një spital. Është spitali që punon kur ajo është në Tiranë: mjeku në turn, laboratorit me reagentë, aparatura që nuk të çon te privati sapo të duhet, ilaçi që gjendet aty ku shteti thotë se e ka blerë, dhe një drejtues që përgjigjet kur diçka dështon. Kaq është testi i saj: sa nga diferenca midis shëndetësisë në letër dhe shëndetësisë që gjen pacienti do të arrijë ta mbyllë.

Nuk do të jetë e lehtë. Shëndetësia është fushë minash dhe minat kanë pronarë. Këto nuk i di vetëm nga raportet. Hyj e dal nëpër spitale prej vitesh, pres në korridore, dëgjoj njerëzit dhe shoh si funksionon sistemi kur nuk ka kamera. Nga ato korridore më është formuar prej kohësh një bindje: farmaceutika funksionon si buxhet paralel, me marrëdhënie financiare që arrijnë deri te mjeku; çmimet e importit fryhen sepse depot e bëjnë tregun; paratë publike paguhen për shërbime që pacienti nuk i merr; dhe pronarë privatë kanë më shumë ndikim mbi një emërim sesa duhet të ketë një interes privat mbi një sistem publik.

Shqipërisë i duhen kompanitë farmaceutike, i duhen spitalet private, i duhet sektori privat. Por sistemi publik i shëndetësisë ka vetëm një arsye për të ekzistuar, pacientin, dhe kur interesi i dikujt tjetër fillon të përcaktojë se çfarë shërbimi merr ai, ministria duhet të dijë të thotë jo.

Këtu do të kuptojmë nëse Rama e ka lexuar drejt Spahiun. Nuk ka zgjedhur një figurë nga jashtë sistemit që duhet të mësojë ku janë dyert. Ka zgjedhur një mjeke që e njuh spitalin, një politikane me peshë të vetën dhe një njeri për të cilin ai vetë thotë se ka besim. Tani është radha e saj. Përlësia do t'i duhet për të dëgjuar gjërat që vartësit nuk kanë qejf t'ia thonë ministres. Profesioni do t'i duhet për të kuptuar kur po i japin shpjegim dhe kur po i shesin justifikim. Pjesa tjetër është më e thjeshtë: një problem që është vetëm përcjellë nuk është problem i zgjidhur.

Mbetet kushti i madh. BESA dhe Prania Besnike nuk mund të bëhen një nga ato çuditë shqiptare që zgjasin tri ditë. Entuziazmi i parë është pjesa e lehtë: ministrat dalin në terren, deputetët dëgjojnë, telefonat hapen, kamerat regjistrojnë. Prova fillon kur kjo nuk është më lajm. Pas gjashtë muajsh, pas një viti, kur drejtori ka kuptuar se vala nuk po kalon, kur ministri e di se nuk mjafton të thotë “e përcolla”, kur qytetari fillon të kërkojë përgjigje jo sepse kryeministri sapo ka shpallur një nismë, por sepse kështu funksionon shteti.

Nëse Rama e ka seriozisht, dhe unë besoj se e ka, duhet ta mbrojë këtë standard edhe nga njerëzit e vet. Sidomos nga njerëzit e vet. Jo duke shkarkuar një ministër sa herë prishet një aparat apo gabon një drejtor; kjo do të ishte teatër. Por kur një ministër e braktis frymën, kur zyra bëhet përsëri më e rëndësishme se terreni dhe raporti më i rëndësishëm se realiteti, kur qytetari kthehet përsëri në bezdi dhe jo në arsyen e punës, aty nuk ka më çfarë të diskutohet. Kush devijon nga ky standard, largohet. Pa negociata politike, pa muaj justifikimesh, pa mbrojtjen automatike që pushteti u jep njerëzve të vet.

Klodiana Spahiu duhet ta dijë këtë, dhe bashkë me të çdo ministër tjetër. Vetëm atëherë “besnike” merr peshë: jo ndaj karriges, jo ndaj ministrit, as edhe ndaj kryeministrit, por ndaj asaj që qeveria ka marrë përsipër t'i japë qytetarit.

Qytetari nuk do t'ia dijë sa takime ka bërë ministria, sa reforma ka prezantuar apo sa kilometra ka përshkuar. Do të dijë nëse, kur i dhemb diçka, shteti është aty. Nëse Klodiana Spahiu e arrin këtë, Rama ka gjetur ministren që po kërkon. Nëse pengesa është sistemi, Rama duhet t'i japë fuqinë për ta thyer. Nëse pengesa bëhet vetë ministria, duhet të kërkojë tjetrën.

BESA dhe Prania Besnike nuk do të gjykojnë nga mënyra si nisën. Do të gjykojnë nga një gjë shumë më e thjeshtë: nëse, këtë herë, nuk mbarojnë pas tri ditësh.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 19 komente

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

[Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:05 Blog / 8 komente

[Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet](#)

12:38 Blog / 20 komente

[Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?](#)

10:25 Blog / 24 komente

[Dinjtet nuk ka vetëm deputeti...](#)

09:42 Blog / 35 komente

[Programi i ri politik i Partisë Demokratike](#)

08:45 Blog / 1 koment

[Lista e Kryetares së Kuvendit](#)

07:57 Blog / 4 komente

[Koinçidenca misterioze e 12 shtatorit, 'Flamingot' përplasen me 'UÇK'](#)

19:20 Blog / 25 komente

[Sa të interesuar janë adoleshentët shqiptarë për politikën?](#)

17:30 Blog

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

["Berisha gënjeu demokratët" - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 17 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...](#)

15:45 Politika / 29 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej "afërën e armëve" m...](#)

15:30 Dossier / 8 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 51 komente

['Kallëzim se po zbatohet ligji', ministri Malaj publikon p...](#)

19:05 Politika / 77 komente

Blog Tema

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 19 komente

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

[Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:25 Blog / 1 koment

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by [Tomorrow.io](#)

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by